

D E K R E T
Nr.1648, datë 20.11.1996

**PËR THELLIMIN E METEJSHËM TË PROCESIT TË PRIVATIZIMIT TË BANKAVE
TREGTARE ME KAPITAL TËRËSISHT SHTETËROR**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”

D E K R E T O J:

Neni 1

Të mbylLEN aktivitetet jofitimprurëse të bankave tregtare me kapital tërësisht shtetëror, si dhe të bëhet ristrukturimi i tyre.

Neni 2

Për mbylljen e aktiviteteve jofitimprurëse, si dhe për rritjen e shpejtësisë së procesit të privatizimit të bankave tregtare me kapital tërësisht shtetëror, të bëhen ndryshimet e nevojshme në rrjetin ekzistues bankar shtetëror dhe në strukturat përkatëse organizative të tyre, pa cenuar shërbimin e pagesave, shërbimin e buxhetit të shtetit dhe garantimin e depozitave në bankat tregtare me kapital tërësisht shtetëror.

Neni 3

Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë të nxjerrin rregulla dhe udhëzime për dhënien e kredive nga bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror në mënyrë që të përmirësohet portofoli ekzistues i kredive dhe për dhënien e kredive të reja vetëm mbi baza të studiara tregtare dhe fitimprurëse.

Kreditë e pakthyera nga persona të ndryshëm kundrejt bankave tregtare me kapital tërësisht shtetëror tej afateve të përcaktuara në marrëveshje, vihen menjëherë në ekzekutim sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile nga përmbartuesi gjyqësor me kërkesën e parë të bankës kredidhënëse.

Neni 4

Detyrimet e njohura deri tani për kreditë bankare të marra nga ish-kooperativat bujqësore, nga ndërmarrjet shtetërore, para datës 30 qershor 1992 dhe të Bankës Bujqësore për Zhvillim, të konvertohen me obligacione të reja me vlerë nominale 1/5 e detyrimit, me një afat shlyerje 20 vjet.

Neni 5

Të gjitha pasuritë e paluajtshme, deri tani në pronësi të shtetit dhe në përdorim të bankave tregtare me kapital tërësisht shtetëror, të kalojnë në pronësi të bankave tregtare me kapital tërësisht shtetëror.

Neni 6

Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë ngarkohen të mbikëqyrin zbatimin praktik të ndryshimeve të nevojshme në strukturat organizative, rrjetin përkatës dhe bilanci të bankave që do të privatizohen brenda datës 31.12.1996.

Neni 7

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda datës 30.11.1996 të miratojë aktet e nevojshme

nënligjore për zbatimin e këtij dekreti.

Neni 8

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIRMOHET
KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha